

1.3.1	Amlodipine/Valsartan
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

FLETUDHËZIM: INFORMATA PËR PËRDORUESIN

Wamlox 5 mg/80 mg film tableta të mbështjellura
Wamlox 5 mg/160 mg film tableta të mbështjellura
Wamlox 10 mg/160 mg film tableta të mbështjellura
amlodipin/valsartan

Lexojeni këtë fletudhëzim të tërën me kujdes para se të filloni ta merrni këtë bar.

- Ruajeni këtë fletudhëzim. Mund t'ju duhet ta lexoni përsëri.
- Nëse keni pyetje të tjera, pyeteni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos ua jepni ate të tjerëve. Mund t'u bëjë dëm atyre edhe nëse simptomat i kanë të njëjta me tuajat.
- Nëse ndonjë nga efektet anësore përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi tregojini mjekut ose farmacistit tuaj.

Në këtë fletudhëzim:

1. Çka është Wamlox dhe për se përdoret
2. Para se të merrni Wamlox
3. Si të merrni Wamlox
4. Efektet e mundshme anësore
5. Si ta ruani Wamlox
6. Informata shtesë

1. ÇKA ËSHTË WAMLOX DHE PËR SE PËRDORET

Wamlox tabletat përmbajnë dy supstanca të cilat quhen valsartan dhe amlodipin. Të dy supstancat ndihmojnë në kontrollimin e tensionit të lartë të gjakut.

- Amlodipina i takon grupit të barnave të cilat quhen „bllikatorë të kanaleve të kalciumit”. Amlodipina parandalon hyrjen e kalciumit në murin e enëve të gjakut dhe në këtë mënyrë parandalon ngushtimin e enëve të gjakut.
- Valsartan i takon trupit të barnave të cilat quhen „antagonistë të receptorëve të angiotenzinës II”. Angiotenzina II krijohet në organizëm dhe shkakton ngushtimin e enëve të gjakut dhe në këtë mënyrë rrit tensionin e gjakut. Valsartani vepron ashtu që bllokon efektin e angiotenzinës II.

Kjo do të thotë se të dy supstancat ndihmojnë në parandalimin e ngushtimit të enëve të gjakut.

Si rezultat, enët e gjakut relaksohen dhe tensioni i gjakut zvogëlohet.

Wamlox përdoret për trajtimin e tensionit të lartë të gjakut te pacientët te të cilët tensioni i gjakut nuk mund të kontrollohet mjaftueshëm kur amlodipina dhe valsartani përdoren veçmas.

2. PARA SE TË MERRNI WAMLOX

Mos e merrni Wamlox:

- nëse jeni alergjik në amlodipin ose çfarëdo bllikatorë të kanaleve të kalciumit. Kjo mund të përfshijë kuarje, skuqe në lëkurë ose vështirësi në frymëmarrje.
- nëse jeni alergjik (të ndjeshëm) ndaj valsartanit ose çfarëdo supstancë ndihmëse të këtij bari (të dhënë në seksionin 6). Nëse mendoni se ekziston mundësia të jeni alergjik, konsultoni mjekun para se të merrni këtë bar.
- nëse keni probleme serioze me mëlçinë ose problemet biliare, siç është ciroza biliare ose holestaza.
- nëse jeni shtatzënë më shumë se 3 muaj (gjithashtu duhet të shmangni marrjen e barit Wamlox, në shtatzëninë e hershme, shihni pjesën Shtatzënia dhe gjdhënia).
- nëse keni tension shumë të ulët të gjakut (hipotension).

1.3.1	Amlodipine/Valsartan
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

- nëse keni ngushtim të valvulave të aortës (stenoza e aortës) ose shok kardiogjen (gjendje në të cilën zemra juaj nuk ka mundësi të furnizojë organizmin me sasi të mjaftueshme të gjakut).
- nëse keni dobësi të zemrës pas përjetimit të infarkt të miokardit.
- nëse keni nivel të lartë të sheqerit në gjak (glukozës) në gjak dhe nëse jeni të sëmurë nga sëmundja e sheqerit diabeti i tipit 2 (i njohur si diabetes mellitus i varur nga insulin) ose nëse keni funksion të zvogëluar të veshkave dhe nëse merrni barna për uljen e tensionit të gjakut që quhet aliskiren.

Nëse çfarëdo nga ato që janë thënë ka të bëjë me juve, mos merrni barin Wamlox dhe konsultoni mjekun tuaj.

Tregoni kujdes të veçantë me Wamlox

Bisedoni me mjekun tuaj ose farmacistin para se të merrni Wamlox.

- nëse keni mundim (vjellje ose diarre).
- nëse keni probleme me mëlçinë ose veshkat.
- nëse keni pasur transplantim të veshkave ose nëse ju është thënë se keni ngushtim të arterieve të veshkave.
- nëse jeni të sëmurë nga gjendja e cila ndikon në gjëndrrat mbiveshkore dhe quhet „hiperaldosteronizmi primar”.
- nëse keni pasur dobësi të zemrës ose nëse keni përjetuar sulm në zemër. Përmbajuni të gjitha udhëzimeve të mjekut me kujdes për dozat fillestare. Mjeku ndoshta do të kontrollojë funksionin e veshkave tuaja.
- nëse mjeku ju ka thënë se keni ngushtim të valvulave të zemrës (gjendje e cila quhet „stenoza e aortës ose mitrale”) ose nëse trashësia e muskulit të zemrës është rritur në mënyrë abnormale, (sëmundje e cila quhet „kardiomiopatia obstruktive hipertrofiqe”).
- nëse ju është paraqitur enjtje gjatë kohës së terapisë me barna të tjera (duke përfshirë inhibitorët e enzimeve të konvertueshme të angiotenzinës), posaçërisht në pjesën e fytyrës dhe fytit. Nëse ju paraqiten këto simptoma, ndaloni të merrni Wamlox.
- nëse merrni çfarëdo nga barnat në vazhdim, të cilat përdoren për uljen e tensionit të lartë të gjakut:
 - ACE inhibitorë (psh. enalapril, lizinopril, ramipril), posaçërisht nëse njëkohësisht keni edhe probleme me veshkat.
 - aliskireni.

Mjeku do të kontrollojë funksionin e veshkave, tensionin e gjakut dhe nivelin e elektroliteve në intervale të rregullta kohore (psh. kaliumi).

Shihni gjithashtu edhe informacionet e dhëna në pjesën "Mos e merrni Wamlox:".

Nëse çfarëdo nga informacionet e dhëna ka të bëjë me juve, konsultoni mjekun para se të merrni barin Wamlox.

Fëmijët dhe adoleshentët

Nuk rekomandohet përdorimi i barit Wamlox te fëmijët dhe adoleshentët (mosha nën 18 vjet).

Marrja e barnave tjera

Ju lutem tregojini mjekut ose farmacistit tuaj nëse jeni duke marrë ose keni marrë barna të tjera kohëve të fundit, duke përfshirë barnat që merren pa recetën e mjekut.

Mjeku ndoshta do të duhet të ndryshojë dozën ose të ndërmarrë masa të tjera të sigurisë. Në disa raste ndoshta do të keni nevojë të merrni një nga këto barna. Kjo para së gjithash ka të bëjë me barnat në vazhdim:

- barnat tjera të cilat përdoren për uljen e tensionit të gjakut dhe quhen ACE inhibitorë ose

1.3.1	Amlodipine/Valsartan
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

- aliskiren;
- diuretikët (lloji i barnave të cilat quhen edhe „tableta për nxjerrjen e ujit” dhe veprojnë ashtu që rritin sasinë e urinës e cila prodhohet);
- litium (barna që përdoren për trajtimin e niveleve të caktuara të depresionit);
- diuretikët që kursejnë kaliumin, suplementet e kaliumit, zëvendësimet për kripë të kuzhinës që përmbajnë edhe supstanca të tjera të cilat mund të rritin nivelin e kaliumit në organizmin tuaj;
- grupi i analgjetikëve që quhen barna josteroide antiinflatore (NSAIL) ose inhibitorë selektiv të ciklooksigenazës 2 (COX-2 inhibitorë). Mjeku ndoshta do të kontrollojë funksionin e veshkëve;
- barnat antikonvulzive (psh. karbamazepina, fenobarbitali, fenitoina, fosfenitoina, primidoni);
- kantaroni;
- nitroglicerina dhe nitratet tjera, respektivisht barnat e quajtura „vazodilatatorë”;
- barna të cilat përdoren në terapinë e HIV/AIDS (psh. ritonavir, indinavir, nelfinavir);
- barna për trajtimin e infeksioneve të kërpudhave (psh. ketokonazol, itrakonazol);
- antibiotikët (barna të cilat përdoren për trajtimin e infeksioneve bakteriale) siç është rifampicina, eritromicina, klaritromicina, talitromicina;
- verapamili, diltiazemi (barna për zemër);
- simvastatina (bar që përdoret për uljen e nivelit të lartë të kolesterolit);
- dantroleni (infuzion te çrregullimi i rëndë i temperaturës së trupit);
- barna të cilat përdoren për parandalimin e përjashtimit të organeve të transplantuara (ciklosporina, tacrolimus).

Marrja e Wamlox me ushqim dhe pije

Personat të cilët marrin barin Wamlox nuk duhet të konsumojnë lëng grejfruti ose fruta grejfruti. Lëngu i grejfrutit dhe frutat e grejfrutit mund të shkaktojnë rritjen e koncentrimin të substancave aktive të amlodipinës në gjak, që mund të shkaktojë rritje të paparashikueshme të efektit të barit Wamlox në uljen e gjakut.

Shtatzënia dhe gjdhënia

Kërkojini këshillë mjekut ose farmacistit para përdorimit të barnave.

Shtatzënia

Duhet të njoftoni mjekun nëse mendoni se jeni shtatzënë (ose mund të jeni shtatzënë). Mjeku juaj do të ju këshillojë që të ndaloni të merrni Wamlox para se të mbeteni shtatzënë ose posa të vërtetoni se jeni shtatzënë dhe do të ju këshillojë që të merrni ndonjë bar tjetër në vend të barit Wamlox. Bari Wamlox nuk rekomandohet në shtatzëninë e hershme (në tremujorin e parë) dhe nuk guxon të merret nëse jeni shtatzënë më gjatë se 3 muaj, sepse mund të shkaktojë dëmtim serioz në organizmin e fëmijës tuaj nëse përdoret pas tremujorit të parë të shtatzënisë.

Laktacioni

Është vërtetuar se Amlodipin kalon në qumështin e nënës në sasi të vogla. Njoftoni mjekun nëse ushqeni foshnjën me gjë ose nëse do të filloni të ushqeni me gjë. Wamlox nuk rekomandohet të merret te nënat të cilat ushqejnë foshnjat me gjë dhe mjeku mund të përzgjedhë një trajtim tjetër për juve nëse dëshironi të vazhdoni të ushqeni beben, posaçërisht nëse bebjë është e porsalindur, ose nëse ka lindur para kohe.

Këshillohuni me mjekun ose farmacistin para se të merrni çfarëdo bari.

Ngasja dhe përdorimi i makinerive

Ky bar mund të shkaktojë marramendje, që mund të ndikojë në aftësinë tuaj të koncentrimin. Nëse nuk jeni të sigurtë se si ndikon ky bar, mos vozitni, mos përdorni makina ose mos ndërmerrni çfarëdo aktivitete për të cilat nevojitet koncentrimi.

1.3.1	Amlodipine/Valsartan
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

Informata të rëndësishme për disa nga përbërësit e Wamlox

Wamlox përmban natrium

Ky bar përmban më pak se 1 mmol natrium (23 mg) për tabletë, që do të thotë se në thelb është "pa natrium".

3. SI TË MERRET WAMLOX

Gjithmonë merrni Wamlox saktësisht siç ju ka udhëzuar mjeku. Duhet të konsultoheni me mjekun ose farmacistin nëse nuk jeni të sigurt. Kjo do të ju ndihmojë që të arrini rezultatet më të mira dhe të zvogëloni rrezikun nga efektet e padëshirueshme.

Doza e zakonshme e barit Wamlox është një tabletë në ditë.

- Këshillohet që barin ta merrni çdo ditë në të njëjtën kohë.
- Gëlltitni tabletat me një gotë ujë.
- Bari Wamlox mund të merret me dhe pa ushqim. Mos merrni Wamlox me grejpfrut ose me lëng grejpfruti.

Mjeku juaj do të ju këshillojë dozat më të mëdha ose më të vogla, varësisht nga përgjigja juaj ndaj terapisë.

Mos përdorni doza më të mëdha se sa ato të rekomanduara.

Wamlox dhe personat e moshuar (mbi 65 vjet)

Mjeku duhet të rritë dozën me kujdes.

Nëse keni pyetje shtesë rreth përdorimit të këtij bari, këshilloni mjekun ose farmacistin.

Nëse merrni Wamlox më shumë se ç'duhet

Nëse keni marrë më shumë tableta Wamlox, ose nëse dikush tjetër ka marrë tabletat tuaja, menjëherë njoftoni mjekun tuaj.

Lëngu i tepërt mund të grumbullohet në mushkëri (edema pulmonare), duke shkaktuar gulçim që mund të zhvillohet deri në 24-48 orë pas marrjes.

Nëse harroni të merrni Wamlox

Mos merrni dozë të dyfishtë për ta kompensuar dozën e harruar.

Nëse keni harruar të merrni barin tuaj, merreni posa të kujtoheni. Pastaj dozën e radhës merreni në kohën e zakonshme. Por, nëse koha e marrjes së dozës së radhës është afër, kalojeni dozën që e keni harruar. Mos merrni dozë të dyfishtë për të kompensuar tabletën e harruar.

Nëse e ndërprisni marrjen e Wamlox

Ndërprerja e aplikimit të barit Wamlox mund të shkaktojë përkeqësimin e sëmundjes tuaj. Mos ndërpreni aplikimin e barit, përveç nëse ju ka thënë mjeku juaj.

Në rast se keni pyetje të mëtejme lidhur me përdorimin e këtij produkti, drejtohuni mjekut ose farmacistit.

4. EFEKTET ANËSORE TË MUNDSHME

Sikurse të gjitha barnat, Wamlox mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo të gjithë paraqiten ato.

1.3.1	Amlodipine/Valsartan
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

Disa efekte të padëshirueshme mund të jenë serioze dhe kërkojnë trajtim urgjent mjekësor:

Këto efekte të padëshirueshme janë paraqitur te disa pacientë (*mund të paraqiten te më së shumti 1 në 1,000 pacientë*). Nëse te ju është paraqitur çfarëdo nga efektet anësore në vazhdim, kontaktoni mjekun menjëherë:

Reagime alergjike me simptoma siç janë puçrrat, enjtja e fytyrës ose buzëve ose gjuhës, frymëmarrje e vështirësuar, tension i ulët i gjakut (ndjenjë e alivanosjes, marramendje).

Efektet tjera anësore të mundshme të barit Wamlox:

Shpesh (mund të paraqiten te më së shumti 1 në 10 pacientë): Influenca (gripi); mbyllje e hundës, dhimbje në fytyrë dhe siklet gjatë qëllitjes; kokëdhimbje, enjtje e duarve, këmbëve, muskujve ose shputave; lodhje, asteni (dobësi); skuqje dhe ndjenjë e nxehtësisë në fytyrë, respektivisht në qafë.

Periodikisht (mund të paraqitet te 1 në 100 pacientë): Marramendje, mundim dhe dhimbje në bark; gojë e thatë; përgjumje, mpirje ose djegie në duar dhe këmbë; marramendje; punë e përsheptuar dhe rrahje e zemrës, marramendje gjatë qëndrimit në këmbë; kollitje; diarje; opstipacion; puçrra në lëkurë; skuqje e lëkurës; enjtje e nyjeve, dhimbje në shpinë; dhimbje në nyje.

Rrallë (mund të paraqiten te më së shumti 1 në 1,000 pacientë): Ndjenjë e shqetësimit; zhurmë në veshë (tinitus); alivanosje; urinim i shtuar ose nevojë e theksuar për të urinuar; pamundësi e arritjes ose mbajtjes së ereksionit; ndjenjë e vështirësimit; tension i ulët i gjakut me simptoma siç janë marramendja, djersitja e shtuar; puçrra në tërë trupin; kruarje; spazëm i muskujve (grçe në muskuj).

Nëse çfarëdo nga efektet e padëshirueshme bëhen serioze, njoftni mjekun tuaj.

Efektet e padëshirueshme të paraqitura individualisht me amlodipin ose valsartan, kurse nuk janë vënë re me barin Wamlox ose paraqiten më rrallë me barin Wamlox:

Amlodipina

Menjëherë njoftoni mjekun nëse ju paraqiten çfarëdo nga efektet e e padëshirueshme shumë të rralla dhe serioze si në vazhdim:

- Fishkëllimë e papritur në gjoks, dhimbje në gjoks, mungesë e frymëmarrjes ose frymëmarrje e vështirësuar.
- Enjtje e qepallave të syve, fytyrës ose buzëve.
- Enjtje e gjuhës dhe fytyrës që shkakton vështirësi të mëdha me frymëmarrjen.
- Reagime të rënda në lëkurë duke përfshirë puçrra të rënda në lëkurë, urtikarie, skuqje të lëkurës në tërë trupin, kruarje e madhe, plika, qërim dhe enjtje e lëkurës, ndezje e mukozës (sindromi i Steven Xhonsonit) se reagime të tjera alergjike.
- Sulm në zemër, ritëm abnormal i zemrës.
- Ndezje e pankreasit, që mund të shkaktojë dhimbje të fortë në pjesën e barkut dhe shpinës dhe bën të ndjeheni shumë keq.

Janë vënë re edhe efektet e padëshirueshme në vazhdim. Nëse ju paraqitet çfarëdo problemi ose nëse zgjatin më shumë se një javë, kontaktoni mjekun tuaj.

Shpesh (mund të paraqitet te 1 në 10 pacientë): Marramendje, përgjumje; palpitacione (ndjenjë e rrahjes së zemrës); skuqje, enjtje (edemë) e muskujve; dhimbje në bark, ndjenjë e mundimit (nausea).

Periodikisht (mund të paraqitet te 1 në 100 pacientë): Ndryshim i disponimit, shqetësim (anksiozë), depresion, përgjumje, dridhje, çrregullim i shijes, dobësi, humbje e ndjenjës së dhimbjes; shqetësime vizuale, dëmtim të shikimit, zhurmë në vesh; për shkak të ndezjes së zgavrës së hundës (rinit); probleme me tretje, vjellje; humbje e flokëve, djersitje e shtuar; kruarje e lëkurës, humbja e ngjyrës natyrore të lëkurës; çrregullim i urinimit; urinim i shpeshtë natën, frekuenca e shtuar e urinimit;

1.3.1	Amlodipine/Valsartan
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

pamundësi e arritjes së ereksionit, siklet në pjesën e gjinjve dhe rritje e gjinjve të meshkujt, dhimbje, ndjenjë e mundimit, dhimbje në muskuj, grçe të muskujve; rritje ose humbje e peshës trupore.

Rrallë (mund të paraqitet te më së shumti 1 në 1,000 pacientë): Konfuzion.

Shumë rrallë (mund të paraqitet te më së shumti 1 në 10,000 pacientë): Numri i zvogëluar i rruazave të bardha të gjakut; zvogëlimi i numrit të trombociteve që mund të shkaktojë mavijosje ose gjakderdhje të lehtë; rritje të nivelit të sheqerit në gjak (hiperglikemia); enjtje e nofullave, ndjenjë e fryrjes së stomakut (gastrit); përkeqësim i funksionit të mëlçisë, ndezje e mëlçisë, (hepatit), ngjyra e verdhë e lëkurës (verdhëza), rritje e vlerave të enzimeve në mëlçi, që mund të ndikojë në rezultatet e disa analizave; tensioni i rritur i muskujve; ndezje e enëve të gjakut e përcjellur me puçrra në lëkurë, ndjeshmëri ndaj dritës.

Nuk është e njohur (frekuenca nuk mund të vlerësohet në bazë të të dhënave të disponueshme): Dridhje, mpirje, fytyrë në formë të maskës, lëvizje të ngadalësuara dhe çalosje, ecje e pabalansuar.

Valsartan

Nuk është e njohur (frekuenca nuk mund të vlerësohet në bazë të të dhënave të disponueshme):

Zvogëlimi i numrit të rruazave të kuqe të gjakut, ethe, dhimbje në fyt ose në gojë, për shkak të infeksioneve; gjakderdhje spontane ose mavijosje; koncentrim i lartë i kaliumit në gjak; rezultate abnormale të analizave të funksionit të mëlçisë; zvogëlim i funksionit të veshkave dhe zvogëlim i ndjeshmëri i funksionit të veshkave, enjtje më e dukshme në fytyrë dhe në qafë; dhimbje në muskuj; puçrra; pika me ngjyrë rozë dhe të kuqe; ethe (temperatura e rritur e trupit); kruarje; reagime alergjike; paraqitje e plikave në lëkurë (shenja të gjendjes që quhet dermatiti buloz).

Nëse çfarëdo nga efektet e padëshirueshme ju paraqitet juve, njoftoni mjekun menjëherë.

Raportimi i efekteve anësore

Nëse ju paraqitet çfarëdo efekti anësor, njoftoni mjekun ose farmacistin. Kjo ka të bëjë me çfarëdo efekti anësor që nuk është dhënë në këtë udhëzim. Efektet anësore mundeni gjithashtu ti raportoni nëpërmjet sistemit nacional për raportim. Me raportimin e efekteve anësore mund të ofroni më shumë informacione rreth sigurisë së këtij bari.

Nëse ndonjë efekt anësor përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi njoftojeni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TË RUHET WAMLOX

Mbajeni larg syve dhe duarve të fëmijëve.

Mos e përdorni Wamlox pas datës së skadimit e cila është e shënuar në karton pas EXP. Data e skadimit i referohet ditës së fundit të atij muaji.

Të ruhet në temperaturë deri në 30°C.

Barnat nuk duhet të hidhen nëpërmjet kanalizimit ose mbeturinave të shtëpisë. Pyeteni farmacistin se si t'i hidhni barnat që nuk ju duhen më. Këto masa do të ndihmojnë për ta mbrojtur mjedisin.

6. INFORMATA SHITESË

Çka përmban Wamlox

- Substancat aktive janë valsartan dhe amlodipin.

1.3.1	Amlodipine/Valsartan
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

Wamlox 5 mg/80 mg film tableta të mbështjellura

1 film tabletë e mbështjellur prej 5 mg/80 mg përmban 5 mg amlodipin (në formë të amlodipin besilatit) dhe 80 mg valsartan.

Wamlox 5 mg/160 mg film tableta të mbështjellura

1 film tabletë e mbështjellur prej 5 mg/160 mg përmban 5 mg amlodipin (në formë të amlodipin besilatit) dhe 160 mg valsartan.

Wamlox 10 mg/160 mg film tableta të mbështjellura

1 film tabletë e mbështjellur prej 10 mg/160 mg përmban 10 mg amlodipin (në formë të amlodipin besilatit) dhe 160 mg valsartan.

- Përbërësit tjerë janë celuloza mikrokristalore, stearat magnezi, kroskarmeloza natrium, povidon, natrium laurilsulfat, manitol dhe silic koloid i anhidruar në bërthamën e tabletës dhe polivinil alkool, titan dioksid (E171), makrogol, talk dhe oksid hekuri i verdhë (E172) në film mbështjellës.
- Shih pjesën 2 "Wamlox përmban natrium".

Si duket Wamlox dhe përbërja e paketimit

Wamlox 5 mg/80 mg film tabletat e mbështjellura janë të kafta në të verdhë, të rrumbullakëta, lehtë bikonvekse, film tabletat e mbështjellura me tehe të pjerrëta dhe me pika të mundshme me ngjyrë të errët.

Wamlox 5 mg/160 mg film tabletat e mbështjellura janë të kafta në të verdhë, ovale, bikonvekse, film tabletat e mbështjellura me pika të mundshme me ngjyrë të errët.

Wamlox 10 mg/160 mg film tabletat e mbështjellura janë me ngjyrë të kaftë të zbehtë në të verdhë, ovale, bikonvekse, film tabletat e mbështjellura.

Blister (OPA/Alu/PVC-Alu foli): 30 film tabletat e mbështjellura në kuti.

Mbajtësi i Autorizimit për Marketing dhe Prodhuesi

KRKA, d.d., Novo mesto, Šmarješka cesta 6, 8501 Novo mesto, Slloveni

TAD Pharma GmbH, Heinz-Lohmann-Straße 5, 27472 Cuxhaven, Gjermani

KRKA – FARMA d.o.o., V. Holjevca 20/E, 10450 Jastrebarsko, Kroaci

Ky fletudhëzim së fundmi është miratuar në
02/2023